

Nr. 2505/044 K (e-k) Prot.
Tiranë, më datë 08/05/2025

Drejtuar: Komisionit Qendror të Zgjedhjeve
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Z. Ilirjan CELIBASHI
Komisionit të Ankimimeve dhe
Sanksioneve

Për dijeni: Komisionerit për Mbikqyrjen e Shërbimit
Civil
Znj. Pranvera STRAKOSHA

Lënda: **DENONCIM Nr. 30** – Lidhur me
shprehjen publikisht të bindjeve,
preferencave dhe mbështetjes partiake e
elektorale nga Drejtori i Drejtorisë
Rajonale të Sigurimeve Shoqërore
Korçë, në përfitim të Subjektit Zgjedhor
“Partia Socialiste e Shqipërisë”.

I nderuar z. Komisioner!

Të nderuar Drejtues të Administratës së KQZ-së!

Të nderuar Anëtarë të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve!

Në datën 21 prill 2025, përfaqësues të lartë të Partisë Socialiste (PS), si drejtuesi politik i Qarkut Korçë, kandidatë për deputetë të këtij qarku, etj, kanë zhvilluar një takim elektorale në fshatin Dishnicë të Qarkut Korçë.

Sikurse duket në fotografite e publikuara në rrjetin social Facebook, në këtë takim kanë marrë pjesë banorë të zonës si dhe:

- Z. Niko Peleshi, *Drejtues politik i PS në Qarkun Korçë*;
- Z. Sotiraq Filo, *Kryetar i Bshkisë Korçë*;
- Z. Ilirjan Pendavinji, *Deputet dhe Kandidat i Partisë Socialiste në Qarkun Korçë*;
- Z. Ilir Bajlos, *Drejtor, Drejtorja Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Korçë*.

Postimet në rrjetin social Facebook të pjesëmarrësve të nivelit të lartë më sipër cituar, me link-un e postimit dhe *print screen* të tij, gjenden në *Lidhjen Nr.1* bashkëlidhur këtij denoncimi.

Ky aktivitet është publikuar edhe në disa portale si Politiko.al, Boldnews.al, etj

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Për nga prezenca në takim, si dhe fjalimet dhe materialet propagandistike të pranishme, vërtetohet fakti që kemi të bëjmë me një takim të karakterit partiak dhe elektoral.

Përpos përfaqësuesve politikë, [nga fotografitë](#) rezulton që **një fjalim natyrshëm elektoral në favor të Subjektit Zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”,** ka mbajtur edhe z. Ilir Bajlos, i cili **rezulton të jetë i punësuar në administratën shtetërore, [në pozicionin e Drejtorit](#) të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Korçë.**

Ligji 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në nenin 37 “*Të drejtat politike*” pika 1 përcakton se: “*Nëpunësi civil ka të drejtë të marrë pjesë në veprimtari politike jashtë orarit zyrtar. Nëpunësi civil nuk duhet të shprehë publikisht bindjet apo preferencat e tij politike*”.

Vendimi nr. 9 datë 24.12.2020 i Komisionit Rregullator, në nenin 6 “*Të drejtat dhe detyrimet e punonjësit të administratës shtetërore*”, pika 5 përcakton se: “**Gjatë pjesëmarrjes në veprimtari politike apo zgjedhore, nëpunësit civil, i ndalohet të shprehë publikisht bindjet apo preferencat e tij politike dhe të bëjë fushatë për një subjekt zgjedhor apo kandidat**”.

Udhëzues nr. 15 datë 15.01.2025 i Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil (KMSHC) “*Për unifikimin e zbatimit të ligjit për nëpunësin civil në drejtim të zhvillimit të procesit të rekrutimit gjatë periudhës zgjedhore; pjesëmarrjes së nëpunësve civilë në institucionet e administrimit të procesit zgjedhor; respektimit të të drejtave të tyre politike e detyrimeve ligjore; ndërveprimin e nëpunësve civilë me "Platformat" apo "Rrjetet sociale" që shfaqen për publikun nëpërmjet internetit, për të shmangur propagandën elektorale; si dhe masat që duhet të marrin institucionet për të monitoruar situatën.*”, përcakton se **nëpunësi civil nuk duhet të shprehë publikisht bindjet apo preferencat e tij politike**, i lidhur ky ndalim me pjesën e parë të saj, pra jashtë orarit zyrtar, në kushtet kur gjatë orarit zyrtar nëpunësi e ka të ndaluar të marrë pjesë në veprimtari politike.

Qëllimi i gjithë dispozitave të mësipërme ligjore është të disiplinojë nëpunësit civilë që të ushtrojnë vetëkontroll për sa i përket manifestimit në publik të pikëpamjeve politike dhe besnikërisë në një forcë politike në jetën private, çka do të thotë që, ata nuk mund të manifestojnë apo të jenë protagonistë në foltoret e subjekteve politike ose elektorale që zhvillojnë fushatën zgjedhore.

Gjithashtu, [Vendimi Nr. 122, datë 26.2.2025](#) i Këshillit të Ministrave “*Për marrjen e masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore të administratës shtetërore, gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet e përgjithshme për vitin 2025*”, në pikën 5 të tij përcakton se: “**Punonjësi i administratës shtetërore, pas orarit zyrtar të punës dhe jashtë mjediseve të institucioneve shtetërore, ka të drejtë të marrë pjesë në veprimtari politike apo zgjedhore të një partie politike ose kandidati në zgjedhje, por pa shprehur publikisht bindjet apo preferencat e tij politike**”.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Në gjykimin e KRIIK, z. Ilir Bajlos **me detyrë Drejtor i Drejtorisë Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Korçë**, edhe nëse ka statusin e nëpunësit civil, por edhe nëse marrëdhënia e tij e punës rregullohet nga Kodi i Punës, është në kushtet e shkeljeve ligjore të specifikuara më sipër, pasi ai është pjesë e administratës shtetërore.

Për gjitha sa më sipër, KRIIK i kërkon Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, **marrjen e masës administrative** ndaj z. Ilir Bajlos me detyrë **Drejtor i Drejtorisë Rajonale e Sigurimeve Shoqërore** Korçë.

Gjithashtu, **KQZ-ja nevojitet që** përpos sanksionimit të nëpunësit përkatës, **të njoftojë zyrtarisht Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil**, i cili është në “cc” të emailit zyrtar të nisur, **për të nisur procedurën disiplinore ndaj tij** sipas parashikimeve ligjore.

Po ashtu, **KRIIK i kërkon KQZ-së edhe marrjen e masës administrative ndaj Subjektit Zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”**, në favor të së cilës është kryer kjo shkelje, bazuar në nenin 172 të Kodit Zgjedhor.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin në vazhdimësi,

Me konsideratë,

**Për Koalicionin Për Reforma, Integrim
dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)**

**Premto Gogo
Kryetar**

Address:


Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

LIDHJA Nr. 1. Printscreen-s të postimeve në faqet zyrtare në Facebook, si dhe të publikimit në median online.

I. Faqja zyrtare në internet e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, ku specifikohet pozicioni i z. Ilir Bajlos si Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, Korçë:



II. Faqja zyrtare në Facebook e z. Ilir Bajlos, Drejtor, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, Korçë:

Dishnicë – me banorë mikpritës e mbështetës të Partisë Socialiste, që na japin energji pozitive dhe besim për të ecur përpara së bashku në rrugën europiane të Shqipërisë.

 Vota e 11 majit është çelësi për të garantuar të ardhmen dhe zhvillimin!

 [#Shqipëria2030nëBE](#)

[#VetëmmeEdindhePS](#) 



Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

III. Faqja zyrtare në Facebook e z. Ilir Pendavinji, Deputet dhe Kandidat i Partisë Socialiste në Qarkun Korçë:

Dishnicë – me banorë mikpritës e mbështetës të Partisë Socialiste, që na japin energji pozitive dhe besim për të ecur përpara së bashku në rrugën europiane të Shqipërisë.

🌹👏 Vota e 11 majit është çelësi për të garantuar të ardhmen dhe zhvillimin!

🇲🇪🇷🇸🇷🇪 [#Shqipëria2030nëBE](https://www.facebook.com/kriik.al)

[#VetëmmeEdindhePS](https://www.facebook.com/kriik.al) 🗳️👏




IV. Faqja zyrtare në Facebook e z. Niko Peleshi, Drejtues Politik i PS në Qarkun Korçë:

Me banorët e Dishnicës, mbështetës të Partisë Socialiste, për rrugën europiane të Shqipërisë dhe mundësitë që sjell integrimi i vendit në Bashkimin Europian.

🌹👏 Vota e 11 majit është çelësi për të garantuar vazhdimësinë e reformave dhe zhvillimit që kemi nisur së bashku.

🇲🇪🇷🇸🇷🇪 [#Shqipëria2030nëBE](https://www.facebook.com/kriik.al)

[#VetëmmeEdindhePS](https://www.facebook.com/kriik.al) 🗳️👏



Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania



V. Portali Politiko.al:



VI. Portali Boldnews.al:



Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania